



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
SENATI AKADEMIK

Nr. 1932/prot.
11

Elbasan, më 15.09.2025

VENDIM

Nr. 63, datë, 15.09.2025

"PËR

PËRSHTATJEN E KUOTAVE TË PAPLOTËSUARA NË PËRFUNDIM TË RAUNDIT TË PARË NË PROGRAMET E STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL DHE TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE BACHELOR PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026"

Bazuar në Ligjin Nr. 80 /2015 datë 22. 07. 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, neni 69, pika 3, në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, pika 2.7/b të ndryshuar "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL", në Vendimin nr. 41, datë 17.03.2025 të Senatit Akademik të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" "*Mbi miratimin e kuotave të pranimit në programet e studimit me karakter profesional në program,et e studimit të ciklit të parë Bachelor dhe në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në fushën e drejtësisë për vitin akademik 2025-2026*, si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.12, datë 30.06.2023, "*Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë*", të ndryshuar, Kreu I, germa D, pika 4, duke ruajtur numrin e përgjithshëm të kuotave për secilën kategori brenda njësisë kryesore, Senati Akademik në mbledhjen e datës 15.09.2025, me propozim të Fakultetit të Shkencave të Edukimit

V E N D O S I:

1. Miratimin e përshtatjes së kuotave të paplotësuara në programet e studimit me karakter profesional dhe atyre të ciklit të parë të studimeve Bachelor në Fakultetin e Shkencave të Edukimit në të njëjtin cikël për vitin akademik 2025-2026 sipas Tabelës nr.1, dhe Tabelës 1/1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Kurrikulave dhe e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Fakulteti i Shkencave të Edukimit.

3. Ky vendim t'i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për procedura të mëtejshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof.Dr. Elvira FETAHU

